

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot në Tiranë, më datë 16/10/2025, palët e mëposhtme bien dakord të lidhin këtë kontratë shitje kuotash (në vijim e referuar si "**Kontrata**") per kalim te një pjese të kapitalit të shoqërisë "**EN CONSTRUCTION**" Shpk (e regjistruar pranë regjistrit tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) më datë 08/06/2023, me NUIS - M36808207V, me kapital 1.000.000 Leke (një milionë), i ndarë në 3 (tre) kuota), me adresë te regjistruar pranë Lagjja "Uji i Ftohte", Rruga "Murat Terbac", Kompleksi Olso, Objekti Nr. 2, Z.K. 8602, Vlorë Shqiperi, ("**Shoqëria**"), si vijon:

SHITËSIT:

- **Z. Klaudio Çaushaj**, shtetas shqiptar, me atësi Bernard, lindur në Vlorë, më datë 16.01.1993, me banim në Tiranë, identifikuar me pasaportën shqiptare me nr. BR2771823, dhe me numer personal identifikimi J301160710, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, ortak zotërues i një kuote ne vlerën e 340 000 Leke (treqind e dyzetë mijë), e barabartë me 34% të kapitalit të shoqërisë "**EN CONSTRUCTION**" Shpk, me NUIS - M36808207V, me seli Lagjja "Uji i Ftohte", Rruga "Murat Terbac", Kompleksi Olso, Objekti Nr. 2, Z.K. 8602, Vlorë Shqiperi, dhe
- **Z. Shkëlqim Beshiri**, shtetas shqiptar, me atësi Liman, lindur në Tiranë, më datë 22/08/1966, me banim në Tiranë, identifikuar me pasaportën shqiptare me nr. BG4903241, e me numer personal G60822041V, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, ortak zotërues i një kuote ne vlerën e 330 000 Leke (treqind e dyzetë mijë), e barabartë me 34% të kapitalit të shoqërisë "**EN CONSTRUCTION**" Shpk, me NUIS - M36808207V, me seli Lagjja "Uji i Ftohte", Rruga "Murat Terbac", Kompleksi Olso, Objekti Nr. 2, Z.K. 8602, Vlorë Shqiperi, **në vijim referuar së bashku në këtë Kontratë si "Shitësit";**

BLERËSI:

- **Z. Arben Prrenjasi**, shtetas shqiptar, me atësi Ahmet, lindur në Voskopojë, më datë 07/02/1967, me banim në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037143650, dhe me nr. personal G70207049Q, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, **referuar në vijim si "Blerësi".**

Shitësit dhe Blerësve do t'ju bëhet referim në këtë Kontratë veçmas si "**Pala**" dhe sëbashku si "**Palët**".

DUKE QENË SE:

- A) Shoqëria "**EN CONSTRUCTION**" Sh.P.K., është një shoqëri e organizuar sipas te drejtës shqiptare, regjistruar pranë regjistrit tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) më datë 08/06/2023, me NUIS - M36808207V, me adresë te regjistruar pranë Lagjja "Uji i Ftohte", Rruga "Murat Terbac", Kompleksi Olso, Objekti Nr. 2, Z.K. 8602, Vlorë Shqiperi, me kapital 1.000.000 Leke (një milionë), i ndarë në 3 (tre) kuota), të zotëruara përkatësisht sipas perqindjeve: i) 34% nga ortaku Klaudio Çaushaj, ii) 33% nga ortaku Shkëlqim Beshiri, dhe 33% nga ortaku Gramoz Qëndro. Aktiviteti i "**EN CONSTRUCTION**" Sh.P.K, konsiston në import - export i te gjitha llojeve te mallrave industriale, ushqimore pjese kembimi etj. Kryerja e ndertimeve te te gjitha llojeve. Investime ne fushen e ndertimit. Punimet e armaturave. Perpunimin e hekurit ne ndertim. Punimin e mureve suvatimeve instalimeve hidraulike dhe elektrike. Ndertimin e rrugeve veprave te artit te perfshira ne to, ndertimin e autostradave, hapjen e kanalizimeve te te gjitha llojeve. Pastrimin e lulishteve si dhe sistemimin e territoreve. Import eksport artikujsh industrial, ushqimore pjese kembimi etj.
- B) Blerësi është i interesuar të blejë nga Shitësit, dhe Shitësit janë të interesuar të shesin tek Blerësi tërësisht kuotat e zotëruara prej tyre në Shoqëri, kuota këto të cilat së bashku përbëjnë 67% të



totalit të kapitalit të shoqërisë “EN CONSTRUCTION” Sh.P.K., dhe janë në vlerën e 670 000 Leke (gjashtë qind e shtatëdhjetë mijë), sipas parashikimeve të kësaj Kontrate.

- C) Blerësi është njohur me aktet, dokumentacionin dhe gjendjen e Shoqërisë dhe nuk ka pretendime apo kërkesa ndaj Shitësve apo Shoqërisë;

Për sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

1. Parashtrimet dhe shtojcat

- 1.1 Parashtrimet dhe shtojcat janë pjesë përbërëse, plotësuese dhe e pandashme e kësaj Kontrate.

2. Objekti i Kontratës

- 2.1 Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësit i kalojnë Blerësit nëpërmjet shitjes kuotat e tyre në Shoqëri, të cilat janë në vlerën e 670 000 Lekë (gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë), e që përfaqësojnë 67% të kapitalit të Shoqërisë, dhe Blerësi pranon të blejë 67% të kapitalit Shoqërisë të zotëruar nga dy Shitësit, kundrejt pagesës së çmimit të shitjes, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

3. Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës

- 3.1 Palët bien dakord se kuotat e kapitalit të “EN Construction” SHPK do të kalohen nepermjet shitjes nga secili prej Shitesve tek Blerësi, me një çmim shitjeje në vlerën nominale të kapitalit, çmim i cili në total do të jetë në shumën 670 000 Lekë (gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) (në vijim referuar si “Çmimi”).

- 3.2 Palët bien dakord se Çmimi i shitjes së kuotave do të paguhet nga Blerësi tek Shitësit si vijon:

- i. 34% e kapitalit të Shoqërisë në vlerën e 340 000 Lekë (treqind e dyzetë mijë) do të transferohet nga Z. Çausaj tek Z. Prrenjasi (Shitës) tek Z. Prrenjasi (Blerësi), në datën e lidhjes së kësaj Kontrate, dhe shuma prej 340 000 Lekë (treqind e dyzetë mijë) e Çmimi do të paguhet brenda 5 ditë kalendarike nga lidhja e kësaj Kontrate, në llogarinë bankare të Shitësit, bashkëlidhur në këtë Kontratë.
- ii. 33% e kapitalit të Shoqërisë në vlerën e 330 000 Lekë (treqind e tridhjetë mijë) do të transferohet nga Z. Beshiri (Shitës) tek Z. Prrenjasi (Blerësi), në datën e lidhjes së kësaj Kontrate, dhe shuma prej 330 000 Lekë (treqind e tridhjetë mijë) e Çmimi do të paguhet 5 ditë kalendarike nga lidhja e kësaj Kontrate nga lidhja e kësaj Kontrate, në llogarinë bankare të Shitësit, bashkëlidhur në këtë Kontratë.

- 3.3 Në vijim të transferimit të kuotave nga Shitësit tek Blerësi, struktura e ortakërisë në Shoqëri dhe zotërimi i kuotave të kapitalit të Shoqërisë do të jenë si vijon:

ORTAKET SHOQERISE PAS TRANSFERIMIT TE KUOTAVE	KUOTA NE SHOQËRI total 2	VLERA ne LEKE	PERQINDJA
Z. Gramoz Qëndro	1 (nje)	330 000	33%
Z. Arben Prrenjasi	1 (nje)	670 000	67%
TOTAL	2	1 000 000	100%

- 3.4 Me pagesën e Çmimit të transferimit të kuotave të Shoqërisë sipas parashikimeve të kësaj Kontrate, Shitësit deklarojnë se nuk ka pretendime ndaj Blerësit, përveç sa përcaktohet tek neni 3.5 më poshtë.

- 3.5 Palët njohin e pranojnë pa rezerva se, detyrimet financiare që Shoqëria ka kundrejt Shitësve në datën e lidhjes së kësaj kontrate, detyrime të cilat kanë lindur nga financimi i akorduar prej Shitësve kundrejt Shoqërisë para lidhjes së kësaj Kontrate, e të cilat janë ende të pashlyera në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, do të vijojnë të mbeten në fuqi e do të

jenë të kërkueshme nga pala Shitëse kundrejt Shoqërise, deri në shlyerjen e plotë të tyre nga Shoqëria.

4. Kalimi i titullit të pronësisë mbi Kuotat

- 4.1 Kalimi i titullit të pronësisë mbi kuotat nga Shitësit tek Blerësi realizohet në datën e kësaj Kontrate.
- 4.2 Administratori i Shoqërisë, Z. Klaudio Caushaj ka shprehur pëlqimin e tij lidhur me keto dy transferime te kuotave te Shoqërisë në përputhje me parashikimet e Statutit të Shoqërisë.
- 4.3 Nga data e kësaj Kontrate, Blerësi, i identifikuar me të dhënat e mësipërme, do të jetë ortak në shoqëri "EN CONSTRUCTION" Shpk, duke zotëruar kuoten e kapitalit sipas përcaktimeve të nenit 3.3 më sipër.
- 4.4 Palët shprehen dhe bien dakord se pas kryerjes të pagesës së Çmimit nga Blerësi përkatësisht tek secili Shitës për transferimin e kuotave te Shoqërisë, ato nuk kanë pretendime ndaj njëra-tjetrës.


5. Dispozita të ndryshme


- 5.1 Shitësit deklarojnë se janë pronarë të ligjshëm të kuotave që transferohen tek Blerësi, te cilat janë të lira nga çdo kufizim, peng apo barrë.
- 5.2 Kjo Kontratë mund të zgjidhet apo ndryshohet me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve. Kjo Kontratë rregullohet nga ligji shqiptar. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin mes Palëve në lidhje me këtë Kontratë do të gjykohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj.
- 5.3 Ndryshimet dhe shtesat e mundshme të kësaj Kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja Palët.
- 5.4 Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet nga Palët në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe.

I bashkëlidhen si anekse kësaj Kontrate, dokumentet e mëposhtme:


1. Ekstrakti i shoqërisë "EN CONSTRUCTION" Shpk;
2. Kopje e dokumenteve të identifikimit të Palëve;
3. Të dhënat e llogarisë bankare të Shitësve.

SHITËSIT


Z. Klaudio Caushaj


Z. Shkelqim Beshiri

BLERËSI


Z. Arben Prrenjasi

